



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22 68 141; 22 68 142

Nr. 40/9 Prot.

Tiranë, më 11.09.2017

V E N D I M

Nr.188, datë 11.09.2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 169, datë 30.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 169, datë 30.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VËREJ SE:

Me vendimin nr.6, datë 18.01.2016, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Rrogozhinë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar procesi i mbikëqyrjes së përgjithshme në Bashkinë Rrogozhinë. Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.169, datë 30.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë", në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Rrogozhinë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmërojë institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e

ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe të Vendimit Nr.116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktuale që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar", duhet të drejtojë procesin e rregullimit të paligjshmërisë së procedurës së deklarimit të statusit të punësimit.

Për punonjësit të cilët në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të sipërcituar kanë qenë të emëruar për një periudhë më pak se një vit, njësia përgjegjëse duhet të kryejë veprimet përkatëse ligjore, për ndryshimin e akteve të deklarimit të statusit të punësimit, duke ndryshuar pozicionin e tyre në raport me shërbimin civil, nga "Nëpunës civil" në "Nëpunës civil në periudhë prove", duke ndjekur hapat si më poshtë:

Për Bashkinë Rrogozhinë:

- Të ndryshojë aktin nr. 328 prot., datë 20.04.2015, për deklarimin e statusit të punësimit "Nëpunës civil", për punonjësen *****, duke e deklaruar si "Nëpunës civil në periudhë prove", për pozicionin e punës "Punonjëse e ndihmës ekonomike".
- Të ndryshojë aktin nr. 327 prot., datë 20.04.2015, për deklarimin e statusit të punësimit "Nëpunës civil", për punonjësin *****, duke e deklaruar si "Nëpunës civil në periudhë prove", në pozicionin e punës "Punonjës PAK + Arkë".
- Të ndryshojë aktin nr. 10/9 prot., datë 10.09.2013, për deklarimin e statusit të punësimit "Nëpunës civil", për punonjësin *****, duke e deklaruar si "Nëpunës civil në periudhë prove", në pozicionin e punës "Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Publike".

Për Njësine Administrative Kryevidh:

- Të ndryshojë aktin nr. 204/1 prot., datë 14.05.2015, për deklarimin e statusit të punësimit "Nëpunës civil", për punonjësin *****, duke e deklaruar "Nëpunës civil në periudhë prove", në pozicionin e punës "Specialist Bujqësie", pranë Njesisë Administrative Kryevidh.

Njësia e burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të evidentojë këtë fakt në Regjistrin e Personelit, me qëllim aplikimin e drejtë të procedurave aktuale në sistemin e karrierës (lëvizje paralele, ngritje në detyrë).

Në kuptim të nenit 24, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, njësia përgjegjëse e këtij institucioni, duhet të kujdeset më tej, që për këta punonjës të realizohet

trajnimi i detyrueshëm pranë ASPA-s dhe të finalizojë këtë proces, mbi bazën e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe mendimit të nëpunësit civil më të vjetër të këtij institucioni.

3. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të drejtojë procesin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të akteve të emërimit, të dala në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pa procedurë të rregullt konkurrimi. Për të rregulluar paligjshmërinë e këtyre akteve, njësia përgjegjëse duhet të veprojë si më poshtë:

Për Bashkinë Rrogozhinë:

- Të revokojë aktin e emërimit nr. 05, datë 07.11.2014, për punonjësën *****, në pozicionin e punës “Inspektore në Sektorin e Taksave”.
- Të revokojë aktin e emërimit nr. 819, datë 28.09.2015, për punonjësën *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin Juridik”.
- Të revokojë aktin e emërimit nr. 19, datë 14.05.2015, për punonjësën *****, në pozicionin e punës “Arkiv Protokoll”.

Për Njësinë Administrative Sinaballaj:

- Të revokojë aktin e emërimit nr. 636, datë 20.08.2015, për punonjësën *****, në pozicionin e punës “Jurist”, në Njësinë Administrative Sinaballaj.

Për Njësinë Administrative Gosë:

- Të revokojë aktin e emërimit nr.1294, datë 10.12.2015, për punonjësën *****, në pozicionin e punës “Arkiv Protokoll”, në Njësinë Administrative Gosë.

Për Njësinë Administrative Kryevindh:

- Të revokojë aktin e emërimit (numër protokollit nuk ka) datë 12.02.2015, për punonjësën *****, në pozicionin e punës “Specialist Finance”, në Njësinë Administrative Kryevindh.
- Të revokojë aktin e emërimit (numër protokollit nuk ka) datë 06.07.2015, për punonjësën *****, në pozicionin e punës “Specialist Arkiv-Protokollit”, në Njësinë Administrative Kryevindh.

Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, për punonjësit e mësipërm, në kuptim të Kreut III, pika 6, e Vendimit Nr. 116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punës me institucionin.

Këto pozicione duhet të shpallen pozicione të lira dhe njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për t'i plotësuar më tej, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Rrogozhinë.

4. *Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të revokojë aktin nr. 329 prot., datë 20.04.2015, më të cilin është bërë deklarimi i statusit të punësimit, për punonjësin *****, në pozicionin "Jurist", në Bashkinë Rrogozhinë, si një akt absolutisht i pavlefshëm, për shkak të mosplotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme të pozicionit të punës (kriterit arsimor).*
5. *Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe të Vendimit Nr. 142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", për punonjësit të cilët në momentin e fillimit të efekteve të këtij ligji, ushtronin detyrën në pozicione pjesë të shërbimit civil dhe nuk plotësonin kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të përshkrimit të pozicionit të punës (kriterin arsimor), duhet të marrë masat si më poshtë:*

Për Bashkinë Rrogozhinë:

- *Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit për punonjësen *****, në pozicionin e punës "Urbaniste", në Sektorin e Urbanistikës*
- *Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit për punonjësin *****, në pozicionin e punës "Inspektor Sporti", në Sektorin e Shërbimeve Publike.*
- *Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit për punonjësin *****, në pozicionin e punës "Inspektor Tatim Taksave", në Sektorin e Tatim Taksave.*

Për Njësinë Administrative Sinaballaj:

- *Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit për punonjësin *****, në pozicionin e punës specialist në "Zyrën e Financës", në Njësinë Administrative Sinaballaj.*

Për Njësinë Administrative Lekaj:

- *Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit për punonjësin *****, në pozicionin "Përgjegjës Administrate", në Njësinë Administrative Lekaj.*

Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, pas përfundimit të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, në kuptim të Kreut III, pika 6, të Vendimit Nr. 116, datë 05.03.2014, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar", për punonjësit e mësipërm duhet të nxjerrë aktet për përfundimin e marrëdhënies së punës me institucionin.

Këto pozicione pune duhet të shpallen të lira, për t'u plotësuar më tej në përputhje me kërkesat e ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Rrogozhinë.

6. *Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në kuptim të nenit 67, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duhet të drejtojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit të cilët, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të posaçëm të shërbimit civil, ishin të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil dhe plotësonin kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të përshkrimit të pozicionit të punës. Për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:*

Për Njësinë Administrative Sinaballaj:

- *Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit "Nëpunës civil" për punonjësen *****, në pozicionin e punës "Administratore Shoqërore", në Njësinë Administrative Sinaballaj.*
- *Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit "Nëpunës civil" për punonjësin *****, në pozicionin e punës, punonjës në "Zyrën e Shërbimeve", në Njësinë Administrative Sinaballaj.*

Për Njësinë Administrative Gosë:

- *Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit "Nëpunës civil" për punonjësin *****, në pozicionin e punës "Përgjegjës i Zyrës së Financës", në Njësinë Administrative Gosë.*
- *Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit "Nëpunës civil" për punonjësin *****, në pozicionin e punës "Jurist & Punonjës Arkive", në Njësinë Administrative Gosë.*
- *Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit "Nëpunës civil" për punonjësen *****, në pozicionin e punës "Punonjëse arkive dhe e marrëdhënieve me publikun", në Njësinë Administrative Gosë.*

Për Njësinë Administrative Lekaj:

- *Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit "Nëpunës civil" për punonjësin *****, në pozicionin e punës "Inspektor Tatim Taksave", në Njësinë Administrative Lekaj.*

Për Njësine Administrative Kryevidh:

- Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil” për punonjës të *****, në pozicionin e punës “Administrator i Ndihmës Ekonomike”, në Njësine Administrative Kryevidh.
7. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, në rastin e punonjës të *****, duhet të revokojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 204 prot., datë 14.04.2015, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës Juridike”, pasi ky pozicion pune nuk ekzistonte në strukturën, e cila ishte në fuqi në datën 26.02.2014, në Njësine Administrative Kryevidh.

Në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për rregullimin e paligjshmërisë, njësia përgjegjëse, për punonjës të ***** duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil”, për pozicionin “Jurist”, në të cilin ky punonjës ka qenë i emëruar në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të sipërcituar.

8. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të drejtojë procesin si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastin kur ka përdorur institutin e transferimit, në një kohë kur duhej të kishte vepruar në përputhje me procedurat e ngritjes në detyrë, për pozicionet pjesë e shërbimit civil, duke marrë masat si më poshtë:

Për Bashkinë Rrogozhinë:

- Të revokojë aktin e transferimit nr. 583 prot., dt 04.08.2015, për nëpunësin ***** për pozicionin e punës “Drejtor i Politikave Urbane”.
 - Të revokojë aktin e transferimit nr. 07 prot., dt 07.11.2014, për nëpunësin ***** për pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Publike”.
 - Të rishikojë mundësinë e kthimit të nëpunësit ***** në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit Ekonomik”, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Rrogozhinë.
 - Të kthejë nëpunësin ***** në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Tatim-Taksave”, i cili aktualisht është i lirë dhe të zgjidhë problemin e periudhës së provës duke plotësuar të gjitha kërkesat e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 - Të shpallë të lira pozicionet e punës “Drejtor i Politikave Urbane” dhe “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Publike”, për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.
9. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, të sistemojë dosjet e personelit të nëpunësve civilë, të cilët ushtrojnë detyrën në Njësitë Administrative Sineballaj, Gosë, Lekaj dhe Kryevidh, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentat dhe të dhënat sipas lidhjes 1 dhe 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen,

procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, dhe ato që janë deklaruar me mungesë në anekset përkatëse, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

- 10. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të drejtojë procesin e krijimit të regjistrit të personelit, sipas përcaktimeve të Vendimit nr.117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, me qëllim që të mundësohet procesi i verifikimit të plotësimi të kushteve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm.*

Ky veprim duhet të jetë në koherencë dhe me punën për të hedhur të dhënat në Regjistrin Kombëtar të Nëpunësve Civilë, që administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

- 11. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, në kushtet e riorganizimit të institucionit, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin Nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015 dhe lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.*

- 12. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, të hartojë planin vjetor të pranimeve të reja në shërbimin civil, sipas kërkesave të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.*

- 13. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procesin e vlerësimeve të rezultateve të punës të punonjësve sipas legjislacionit të shërbimit civil, në zbatim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”.*

- 14. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa të menjëhershme në lidhje me emërtimet e pozicioneve të punës, pjesë e shërbimit civil, në strukturën e institucionit sipas kërkesave të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

- 15. Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, të rivlerësojë pesë procedimet disiplinore për disa punonjës të Bashkisë Rrogozhinë si dhe të Njësive Administrative (përshkruar në procesverbalin e mbajtur midis grupit të punës dhe Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse *****, në datën 29.01.2016), pasi nuk ka vepruar drejt në lidhje me respektimin e procedurës ligjore sipas neneve 57, deri në 60, të Kreut X, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.115*

datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor”.

16. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dëjani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr.169, dt.30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”, me vendimin nr.118, datë 05.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 169, datë 30.12.2016”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 169, datë 30.12.2016.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje nëpunësit Ilirjan Osmanlliu dhe Joni Marko, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 15.05.2017, u paraqitën pranë institucionit Bashkia Rrogozhinë.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në lidhje me rekomandimin e Komisionerit për ndryshimin e akteve të deklaramit të statusit të punësimit nga “nëpunës civil” në “nëpunës civil në periudhë prove”, përcaktuar në pikën 2 të vendimit, u konstatua se:

Për Bashkinë Rrogozhinë

- Nga ana e njësies përgjegjëse nuk ka dalë akti formal “Nëpunës civil në periudhë prove”, për punonjësen ***** në pozicionin “Specialiste e ndihmës ekonomike”. Nga ana tjetër, pas përfundimit të periudhës së provës sipas përcaktimeve ligjore të nenit 24 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr.722, datë 01.03.2017 për konfirmimin si nëpunës civile për këtë punonjëse në pozicionin e mësipërm “Specialiste e ndihmës ekonomike”.
- Nga verifikimi në subjekt, nuk rezultoi të ketë ndonjë akt formal që provon zbatimin e rekomandimit të Komisionerit për ndryshimin e aktit administrativ nr.327, datë 20.07.2015, nga nëpunës civil, në nëpunës civil në periudhë prove për punonjësin ***** në pozicionin “Punonjës PAK+Arkë”. Megjithatë, referuar faqes zyrtare të internetit të Departamentit të Administratës Publike, rezultoi se ky punonjës është përfshirë në listën e punonjësve për kryerjen e trajnimit në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 152.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Në rastin e punonjësit ***** me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike”, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar për ndryshimin e aktit administrativ

nr.10/9, datë 10.09.2013, për deklarimin e statusit të punësimit të këtij punonjësi, pasi referuar aktit administrativ nr.15/8, datë 15.08.2011, rezulton se, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ai ka qenë i punësuar në këtë pozicion për më shumë se 1 vit dhe bazuar në nenin 67, pika 3 të këtij ligji ai është nëpunës civil. Ky fakt nuk ka qenë e mundur të konstatohet nga grupi i mbikëqyrjes për shkak se nuk iu është vënë në dispozicion akti i emërimit të punonjësit.

Për Njësinë Administrative Kryevidh

- Në rastin e punonjësit ***** me detyrë “*Specialist Bujqësie*”, në Njësinë Administrative Kryevidh, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar për ndryshimin e aktit administrativ nr.204/1, datë 14.05.2015, për deklarimin e statusit të punësimit të këtij punonjësi, pasi referuar aktit administrativ, nr.1/14, datë 01.07.2011 rezulton se, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ai ka qenë i punësuar në këtë pozicion për më shumë se 1 vit dhe bazuar në nenin 67, pika 3 të këtij ligji ai është nëpunës civil. Ky fakt nuk ka qenë e mundur të konstatohet nga grupi i mbikëqyrjes për shkak se nuk iu është vënë në dispozicion akti i emërimit të punonjësit.
- Në zbatim të pikës 3 vendimit, në të cilën nga ana e Komisionerit është kërkuar revokimi i akteve të emërimit të dala në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton sa më poshtë:

Për Bashkinë Rrogozhinë

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë nuk ka revokuar aktet e emërimit për punonjësit ***** në pozicionin e punës “*Inspektore në Sektorin e Taksave*”, ***** në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin Juridik*” dhe ***** në pozicionin e punës “*Arkiv Protokoll*”, por këto pozicione janë shpallur të lira, fakt i cili provohet me shkresat nr.2913, datë 10.11.2016 dhe nr.1842, datë 19.05.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të administruara nga grupi i verifikimit.

Për Njësinë Administrative Sinaballaj

Nga përmbajtja e listëpagesës së punonjësve të Njesisë Administrative Sinaballaj për muajin prill 2017, nuk rezulton të jetë pjesë e kësaj administrate punonjësi ***** me detyrë “*Jurist*”, për të cilin është kërkuar revokimi i aktit administrativ të emërimit nr. 636, datë 20.08.2015. Po kështu nuk ekziston më në strukturë pozicioni i punës “*Jurist*”, çka presupozon ndërprerjen e marrëdhënies së punës për këtë punonjës.

Për Njësinë Administrative Gosë

Me Urdhrin nr.1086, datë 28.03.2017, “Për ndryshimin e pozicionit të punës për punonjës të kontratë pune, Bashkia Rrogozhinë”, punonjësi ***** me detyrë “*Specialist Arkiv-Protokoll*”, është larguar nga ky pozicion dhe është emëruar në një

pozicion tjetër, jashtë fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil (*punonjës shërbimesh*).

Për Njësinë Administrative Kryevidh

Me Urdhrin nr.1039, datë 23.03.2017, “Për ndryshimin e pozicionit të punës për punonjësin me kontratë pune, Bashkia Rrogozhinë”, punonjësi ***** me detyrë “*Specialist finance*”, është larguar nga ky pozicion dhe është emëruar në një pozicion tjetër, jashtë fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil (*arkëtar*).

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë nuk ka revokuar aktin e emërimit për punonjësin ***** në pozicionin e punës “*Specialist arkiv-protokoll*” në Njësinë Administrative Kryevidh, por këtë pozicion e ka shpallur të lirë, fakt i cili provohet me shkresën nr.1842, datë 19.05.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të administruara nga grupi i verifikimit

- Njësia përgjegjëse nuk ka zbatuar rekomandimin e pikës 4 të vendimit të Komisionerit, për faktin se punonjësi ***** për të cilin është kërkuar revokimi i aktit të deklarimit të statusit të punësimit, për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor, gjatë verifikimit në subjekt rezultoi se ai i plotëson kriteret e posaçme (*kriterin arsimor*) për të qenë nëpunës civil në kuptim të ligjit, pasi ka përfunduar studimet universitare në vitin 2008, duke marrë titullin “*Jurist*”. Ky fakt nuk ka qenë e mundur të konstatohet nga grupi i mbikëqyrjes për shkak se diploma e këtij punonjësi nuk ka qenë në dosjen individuale të punonjësit në momentin e mbikëqyrjes. Aktualisht, nga komunikimi me njësinë përgjegjëse të Bashkisë Rrogozhinë dhe listëprezenca e muajit prill 2017, rezulton se punonjësi i mësipërm nuk është më pjesë e strukturës së kësaj bashkie, pasi është larguar nga detyra me kërkesën e tij.
- Në zbatim të pikës 5 të vendimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, ka vepruar në përputhje me rekomandimin e Komisionerit, si më poshtë vijon:
 - Me Urdhrin nr.2908, datë 09.11.2016, punonjësja ***** është larguar nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si “*Urbaniste*”, në Bashkinë Rrogozhinë dhe është emëruar në një pozicion tjetër, jashtë fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil (*Inspektore IKMV*), për shkak të mospërshtatjes së arsimit me pozicionin e punës.
 - Me Urdhrin nr.2871, datë 04.11.2016, punonjësi ***** është larguar nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si “*Inspektor sporti*”, në Bashkinë Rrogozhinë dhe është emëruar në një pozicion tjetër, jashtë fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil (*Punonjës shërbimesh*), për shkak të mospërshtatjes së arsimit me pozicionin e punës.
 - Me Urdhrin nr.1022, datë 23.03.2017, punonjësi ***** është larguar nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si “*Specialist Arkiv-Protokoll*”, në Njësinë Administrative Lekaj dhe është emëruar në një pozicion tjetër, jashtë fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil (*Punonjës shërbimesh*), për shkak të mospërshtatjes së arsimit me pozicionin e punës.

- Punonjësi ***** është larguar nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si “*Specialist në zyrën e financës*”, në Njësinë Administrative Sinaballaj dhe është emëruar në një pozicion tjetër, jashtë fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil (*mbledhës taksa tarifa*), fakt i cili provohet nga listëpagesa e Njësisë Administrative Sinaballaj e muajit Prill 2017.
- Me Urdhrin nr. 2932, datë 14.11.2016, punonjësi ***** është larguar nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si “*Inspektor tatim-taksash*”, në Bashkinë Rrogozhinë për shkak të dorëheqjes dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Pavarësisht zbatimit jo korrekt të rekomandimit të Komisionerit në këtë rast, për shkak se punonjësit në fjalë marrëdhënia e punësimit duhej t’i ndërpritej për shkak të mospërmbushjes së kriterit arsimor, duke qenë se tashmë ai është larguar nga shërbimi civil, duke mos i njohur asnjë nga të drejtat që ligji iu njeh nëpunësve civilë, kjo detyrë e lënë njësisë përgjegjëse do të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen kësaj të fundit që në të ardhmen të zbatojë me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Pozicionet e mësipërme që mbanin këto nëpunës janë shpallur të lira me shkresat nr. nr.2913, datë 10.11.2016 dhe nr.1842, datë 19.05.2017, “*Plani Vjetor i Pranimit në Shërbimin Civil për vitet 2016 dhe 2017*”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

- Bazuar në nenin 67 pika 3 të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe në zbatim të pikës 6 të Vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit për punonjësit që plotësonin kriteret ligjore si më poshtë:

Për Njësinë Administrative Sinaballaj

- Me aktin administrativ nr.2833, datë 03.11.2016, punonjësja ***** është konfirmuar “*Nëpunëse civile*” në pozicionin e punës “*Administratore shoqërore*”, në Njësinë Administrative Sinaballaj;
- Për punonjësin ***** , nuk ka dalë akti i deklaramit të statusit të punësimit në pozicionin e punës “*Specialist në zyrën e shërbimeve*”, sepse bazuar në nenin 65, pika c të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, punonjësit i ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil, për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë (*karta e identitetit, dtl.06.03.1951*).

Për Njësinë Administrative Gosë

- Me aktin administrativ nr.2869, datë 04.11.2016, punonjësi ***** është konfirmuar “*Nëpunës civil*” në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”, në Njësinë Administrative Gosë;
- Me aktin administrativ nr.2870, datë 04.11.2016, punonjësi ***** është konfirmuar “*Nëpunës civil*” në pozicionin e punës “*Specialist Jurist*”, në Njësinë Administrative Gosë;

- Me aktin administrativ nr.2868, datë 04.11.2016, punonjësja ***** është konfirmuar “Nëpunëse civile” në pozicionin e punës “Specialiste Arkiv-Protokolli”, në Njësinë Administrative Gosë.

Për Njësinë Administrative Lekaj

- Me aktin administrativ nr.2867, datë 04.11.2016, punonjësi ***** është konfirmuar “Nëpunës civil” në pozicionin e punës “Inspektor i Tatim-Taksave”, në Njësinë Administrative Lekaj.

Për Njësinë Administrative Kryevindh

- Me aktin administrativ nr.2867, datë 04.11.2016, punonjësi ***** është konfirmuar “Nëpunës civil” në pozicionin e punës “Administrator i Ndhmës Ekonomike”, në Njësinë Administrative Kryevindh.
- Në pikën 7 të vendimit të Komisionerit është kërkuar revokimi i aktit të deklaramit të statusit të punësimit nr. 204 prot., datë 14.04.2015, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës Juridike”, për punonjësin *****, për shkak se ky pozicion nuk ekzistonte më në strukturën që ishte në fuqi në datën 26.02.2014. Nga verifikimi në subjekt, rezultoi se njësia përgjegjëse dispononte një deklaratë të punonjësit të datës 18.09.2015, me anë të së cilës ai hiqte dorë nga pozicioni i mësipërm dhe ishte dakord të punonte në pozicionin “Specialist Jurist”. Më tej, me aktin nr. 2759/1, datë 31.10.2016, ky punonjës është liruar nga detyra e Juristit. Pavarësisht faktit se punonjësi ***** nuk punon më në pozicionin e Përgjegjës të Zyrës Juridike, njësia përgjegjëse ka detyrimin që bazuar në 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të anulojë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për këtë punonjës, duke nxjerrë një akt të ri.
- Në pikën 8 të vendimit të Komisionerit është kërkuar revokimi i akteve të transferimit nr. 583 prot., datë 04.08.2015, për nëpunësin *****, për pozicionin e punës “Drejtor i Politikave Urbane” dhe aktin nr. nr.07, datë 07.11.2014, për punonjësin ***** në detyrën “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Publike”, pasi emërimi i punonjësve në këto pozicione duhej të ishte bërë duke aplikuar institutin e ngritjes në detyrë.

Nga verifikimi në subjekt rezultoi se njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka revokuar aktin nr. 583 prot., datë 04.08.2015, për nëpunësin *****, por ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin “Drejtor i Politikave Urbane”. Pas përfundimit të procedurave të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me aktin e emërimit nr.1736, datë 13.07.2016, punonjësi ***** është emëruar në pozicionin e punës “Drejtor i Politikave Urbane”.

Në rastin e punonjësit ***** në përfundim të verifikimit rezultoi se njësia përgjegjëse nuk e ka revokuar aktin e transferimit nr.07, datë 07.11.2014, në pozicionin

“Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Publike”. Referuar nenit 25 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, njësia përgjegjëse duhej të kishte përdorur institutin e lëvizjes paralele për kalimin e këtij punonjësi nga pozicioni “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Tatim-Taksave” në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Publike”. Për shkak të mosrespektimit të procedurës së përcaktuar nga ligji në këtë rast, referuar nenit 108 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, akti i transferimit të këtij punonjësi është absolutisht i pavlefshëm. Për këtë arsye, njësia përgjegjëse, referuar nenit 113 të këtij ligji, duhet të bëjë anulimin e këtij akti, duke nxjerrë një akt të ri dhe, më tej, të kthejë punonjësin ***** në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Tatim-Taksave”. Pozicioni “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Publike” duhet të shpallet pozicioni i lirë pune për t’u plotësuar përmes procedurave që përcakton ligji (nëpërmjet institutit të ngritjes në detyrë ose lëvizjes paralele, procedurë në të cilën mund të marrë pjesë edhe punonjësi në fjalë).

- Në zbatim të pikës 9 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse ka plotësuar dosjet e personelit të nëpunësve civilë në Njësitë Administrative Sinaballaj, Gosë, Lekaj dhe Kryevindh me dokumentacionin e munguar, i cili është konstatuar gjatë mbikëqyrjes në subjekt. (mungesa e raporteve mjekësore, dëshmitë e penalitetit etj) në përputhje me VKM nr.117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, në zbatim të pikës 10 të vendimit të Komisionerit ka krijuar regjistrin e personelit dhe ka pasqyruar në të informacionin për strukturën dhe të dhënat dytësore në lidhje me pozicionin e punës dhe arsimin e nëpunësve civilë të kësaj bashkie në përputhje me pikën 6 të Kreut II të VKM nr.117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Në momentin e verifikimit, ky proces ishte në vazhdim dhe përmirësim të vazhdueshëm nga ana e njësisë përgjegjëse, për t’u plotësuar me të gjithë informacionin e nevojshëm.
- Në zbatim të pikës 11 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë kishte hartuar dhe miratuar përkrahjet e punës, për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015 dhe lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil” (kopje të të cilave janë administruar nga grupi i punës).
- Njësia përgjegjëse në zbatim të rekomandimit të pikës 12 të vendimit të Komisionerit, me shkresat nr.1842, datë 19.05.2017 dhe nr. 2913, datë 10.11.2016, bazuar në Vendimin nr.108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, ka planifikuar përfshirjen e të gjitha pozicioneve të punës që janë zënë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar, të cilat janë konstatuar në pjesën urdhëruese të vendimit të Komisionerit si dhe ato që realisht janë të lira në strukturën organizative të miratuar me Urdhrin nr.728, datë 01.03.2017, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë.

- Në lidhje me rekomandimin për kryerjen e procesit të vlerësimeve të rezultateve të punës të punonjësve sipas legjislacionit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 13 të vendimit të Komisionerit kishte kryer procesin e vlerësimit të punës për vitin 2016, bazuar në nenin 62 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil” (bashkëngjitur kopje e formularit të vlerësimit të punës për vitin 2016).
- Njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 14 të vendimit, pasi ka përcaktuar më parë detyrat konkrete për çdo pozicion pune të cilat janë pasqyruar dhe në përshkrimet e punës, bazuar në nenin 19, pika 1 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka bërë klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Procesi i mësipërm është materializuar në Urdhrin nr.728, datë 01.03.2017, të kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Rrogozhinë”.
- Në lidhje me rekomandimin për rivlerësimin e pesë procedimeve disiplinore për disa punonjës të Bashkisë Rrogozhinë dhe të njëjve administrative (pika 15 e vendimit), pjesë e kësaj bashkie, rezultoi se njësia përgjegjëse, nuk kishte marrë asnjë masë për respektimin e procedurës së përcaktuar në nenin 57 deri 60, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Megjithatë, nga komunikimi verbal me përfaqësues të kësaj njësie, është marrë angazhimi për zbatimin e rekomandimit të kësaj pike të vendimit.

Për sa u përket më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 169, datë 30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”, të Komisionerit, rezultoi se nga njësia përgjegjëse nuk janë zbatuar të gjitha rekomandimet e Komisionerit. Për këtë arsye, do të jenë objekt i verifikimit të mëtejshëm nga ana e Komisionerit, pikat e mëposhtme:

1. Pika 7 e vendimit të Komisionerit, për zbatimin e së cilës njësia përgjegjëse duhet të kryejë anulimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit nr. 204 prot., datë 14.04.2015, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës Juridike”, për punonjësin *****, në përputhje me orientimin e bërë më sipër.
2. Pika 8 e vendimit të Komisionerit, në rastin e punonjësit *****, për të cilin, njësia përgjegjëse duhet të bëjë anulimin e aktit të transferimit nr.07, datë 07.11.2014, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Publike”, duke nxjerrë një akt të ri dhe, më tej, të kthejë këtë punonjës në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Tatim-Taksave”. Pozicioni “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Publike” duhet të shpallet pozicion i lirë pune për t’u plotësuar përmes procedurave që përcakton ligji (nëpërmjet institutit të ngritjes në detyrë ose lëvizjes paralale, procedurë në të cilën mund të marrë pjesë edhe punonjësi në fjalë).

3. Pika 15 e vendimit të Komisionerit, për rivlerësimin e pesë procedimeve disiplinore për disa punonjës të Bashkisë Rrogozhinë dhe të njëjësive administrative, pjesë e kësaj bashkie.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të pjesshëm të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit Bashkia Rrogozhinë për zbatimin e Vendimit nr. 169, datë 30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”.
2. Verifikimin e mëtejshëm të zbatimit të rekomandimeve të pikave 7, 8 dhe 15 të Vendimit nr. 169, datë 30.12.2016.
3. Njësia përgjegjëse dhe Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë duhet të zbatojnë rekomandimet e pikave 7, 8 dhe 15 të Vendimit nr. 169, datë 30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”, brenda një afati prej **30** ditësh nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Rrogozhinë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA